

PLANI SOCIAL 2023-2026

Bashkia Prrenjas



Nëntor 2022

Finalizimi dhe kostimi i Planit Social 2023-2026 të Bashkisë Prrenjas u mbështet nga UN Women në Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas 2" (LNB 2), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, përmes Fondit të Përshpejtitimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

PERMBAJTJA

HYRJE	2
1. PRIORITETET NË ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR	4
2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE	5
3. TREGUESIT SOCIAL	10
4. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL	11
4.1 Parimet	11
4.2 Vizioni	11
4.3 Objektivat	11
Objektivi strategjik 1: Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale.....	11
Objektivi strategjik 2: Fuqizimi i qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale	12
Objektivi strategjik 3: Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror	12
Objektivi strategjik 4: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë	13
Objektivi strategjik 5: Përfshirja e grupeve vulnerabël në proceset e vendimarrjes	13
5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT	14
PLANI SOCIAL BASHKIA PRRENJAS	16
<i>ANKES 1: PERMBLEDHJE E BUXHETIT</i>	<i>44</i>
<i>ANEKS2. TREGUESIT SOCIAL</i>	<i>45</i>

Dokumenti i Planit Social Vendor 2023-2026 u hartua bazuar në vlerësimin e Planit Social 2019-2022 duke siguruar vazhdimësi dhe përditësim të planifikimit dhe të plotësimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Prrenjas.

Ky dokument do të jetë vazhdim i politikës për zbutjen e varfërisë, krijimin e kushteve për individët, gratë e burrat, familjet dhe fëmijët e Bashkisë Prrenjas që janë në situata varfërie të përballojnë efektet negative që ajo shkakton si vulnerabilitetin dhe përjashtimin social.

Në kontekstin institucional përgatitja dhe zbatimi i Planit Social Lokal është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore në përputhje me Ligjin 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri*”.

Pas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*” dhe bazuar dhe në ligjin nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore. Dhe konkretisht Neni 24 i këtij Ligji përcakton funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale përkatësisht për:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social përfinancimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Detyrimi i Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, për ti planifikuar dhe ngritur këto shërbime rrjedh edhe nga Ligji nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”. Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar, sikurse dhe rregullimet me akte nënligjore të Fondit Social, si mekanizëm financiar për shërbimet e kujdesit shoqëror, i vijnë në ndihmë Bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël.

Legjislacioni në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbrojtjes së fëmijëve dhe masave kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, përcakton detyrimin e Bashkive për ngritjen jo vetëm të strukturave përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në nivelin e Bashkisë, por edhe ngritjen e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në nivelin e Njësive Administrative, sikurse Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Njësia të barazisë gjinore dhe pikës lokale për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale e periudhes 2015-2020 jepte një orientim të qartë politikash për kujdesin shoqëror, duke synuar reformimin e sistemit duke përdorur një qasje me faza për ta zhvilluar këtë sistem. Me miratimin nga Këshilli i Ministrave të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023-2026 në datë 24.12.2019 **kemi tashmë te adresuara objektiva te qarta dhe te matshme per mbrojtjen sociale në Shqipëri**. Ky dokument reflekton parimet themelore të një sistemi modern të mbrojtjes sociale. Strategjia reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale, duke synuar që t’i sigurojë çdo qytetari shqiptar, burrë, grua, djalë apo vajzë, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe **duke adresuar “qasjen e ciklit të jetës”**.

Kjo strategji hartohet në përputhje me nenet 70 dhe 99, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Dokumentit të Partneritetit 2007 dhe përmbush detyrimet që burojnë nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2014–2020. Propozon ndërhyrje prioritare nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivel kombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje.

Risi e kësaj strategjie është reformimi i parimeve dhe sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke propozuar një model të ri multidisiplinor biopsikosocial i bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për vlerësimin në tërësi të nevojave të individit, i rritur apo fëmijë, me aftësi të kufizuara dhe jo duke u fokusuar vetëm në diagnostikimin e tyre. **Qasja e re** përfshin një paketë të plotë të integruar për PAK-në që nga identifikimi i hershëm, diagnostikimi, vlerësimi i nevojave, menaxhimin e rastit të plotë që nga këshillimi, rehabilitimi nëpërmjet shërbimeve të specializuara sociale dhe shëndetësore, dhe sipas rastit edhe integrimi për punësim dhe arsimim apo kualifikime profesionale.

Zhvillimi i shërbimeve të **përkujdesjes alternative**, është një përgjigje ndaj institucionalizimit të grupeve në nevojë, sidomos fëmijëve. Shërbimet e asistencës shtëpiake për të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar, shërbimet për familjen dhe prindërimin, transformimi i institucioneve të përkujdesjes sociale, janë prioritetet thelbësore të strategjisë. Për herë të parë nëpërmjet **krijimit të një linje buxhetore të veçantë**, Fondit Social, dhe alokimit të buxhetit qendror **mundësohet që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet** në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (apo shporta e shërbimeve), si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale sipas nevojave të specifikuar në Planin Social të çdo bashkie. Kjo strategji është projektuar drejt **maksimizimit të përfitimeve sociale** dhe shmangien ose minimizimin e rreziqeve sociale, veçanërisht për grupet vulnerabël dhe të marginalizuara. Ajo nxit ofrimin e shërbimit të integruar të mbështetjes duke bashkërenduar ndihmën në natyrë me atë në pagesa dhe shërbime shoqërore. Është politikë kyçe për përmirësimin e cilësisë së jetës, pasi nuk kufizohet vetëm në ciklin e jetës, por përfshin gjerësisht familjen, fëmijët dhe individin në nevojë.

Në procesin e planifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror Bashkia Prrenjas **u bazua** në nevojat për shërbime të identifikuar të individëve, grave dhe burrave dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standartet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillim

1. PRIORITETET NË ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për shërbime sociale në territorin e saj të identifikuar përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimet me stafin, dhe takimet e zhvilluara me aktorët e tjerë, më poshtë ju paraqesim prioritetet në zhvillimin shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Prrenjas, si pjesë të Planit Social 2022-2026:

Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese

- Informimi i qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet e kujdesit shoqëror.
- Informimi i aktorëve përkatës mbi rolet dhe përgjegjësitë në identifikimin, referimin e rasteve në nevojë për shërbime, si dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Identifikim proaktiv i rasteve të individëve në nevojë për shërbime dhe referimi tek shërbimet specifike.

Zhvillimi i shërbimeve të reja

Persona me aftësi të kufizuara dhe fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitues të ndihmës ekonomike dhe fëmijë të këtyre familjeve, punëkërkuar të papunë, viktimat e dhunës në familje, familje të pastreha, të moshuar në nevojë për shërbime, familje që kanë përjetuar divorc, fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial, fëmijë në nevojë për mbrojtje, fëmijë në familje kujdestare, fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar, përdorues droge, viktimat trafikimi, familje/individ të kthyer nga emigracioni, familje rome dhe egjiptiane në nevojë për shërbime, do të përfitojnë nga sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror që synohet të ngrihet në Bashkinë Prrenjas.

Shërbimet kryesore që do të ngrihen përfshijnë:

- ✓ Vazhdimësi e projektit të Qendrës Komunitare për Shërbime ndaj Aftësisë të Kufizuar për të fëmijet dhe të rinjtë, ku përveç shërbimeve rehabilituese terapeutike ditore në qëndër do të mundësohet dhe ofrimi i shërbimit në banesë për të gjitha familjet që nuk kanë mundësi të sjellin fëmijët me aftësi të kufizuar pranë ambjentëve të qëndres .Duke u ardhur në ndihmë me shërbimin lëvizës: terapi në shtëpi sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
- ✓ Studim për aksesueshmërinë dhe ndërhyrje në infrastrukturën publike me qëllim heqjen e barrierave të lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara fizike.
- ✓ Për familjet ekstremisht të varfëra mbështetje me paketa ushqimore, veshmbathje.
- ✓ Ndihmë financiare për rastet emergjente të ndihmuara nga Fondi Social në bashki .
- ✓ Rritje e numrit të çerdheve dhe vendosja e kuotave në kopshte dhe çerdhe për fëmijët e familjeve më në nevojë për të marrë shërbimin papagesë.
- ✓ Ndërveprim me shërbimet e punësimit për zhvillimin i programeve të nxitjes së punësimit. Programe integrimi në tregun e punës për pjestarët madhorë burra dhe gra kryefamiljare të familjeve në ndihmë ekonomike duke ndjekur hapat vijues:
 - Studim të tregut të punës në Bashkinë Prrenjas;
 - Vlerësimi real i nevojave për punë;
 - Vlerësimi i profileve të mundshme të punësimit;
 - Ofrimi i kurseve të formimit profesional sipas profilit të identifikuar nga studimi
- ✓ Riaktivizimi i shërbimit të emergjencës 72 orëshe për viktimat e dhunës në familje.
- ✓ Trajtimi me prioritet për strehim i viktimave të dhunës në familje.
- ✓ Këshillim për familjet që kanë përjetuar dhunë në familje.
- ✓ **Vazhdimësi e Qendrës Ditore për të moshuarit e kombinuar me shërbim të asistencës shtëpiake për të gjithë të moshuarit në nevojë.**
- ✓ Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare.
- ✓ Ngritja dhe funksionimi i një **qendre multifunksionale** që ofron shërbime për fëmijën dhe familjen,

ku do të përfshihen këto shërbime:

- *Programe këshillimi për prindërimin*
- *Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm*
- *Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje*
- *Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm)*
- *Shërbime në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për terapi zhvillimi dhe distanca nga qendra multifunksionale i pengon në marrjen e shërbimit*
- *Shërbim rehabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin*
- *Shërbim lëvizës në familje*
- *Këshillim për punësimin*
- *Programe për përdoruesit e drogave*
- *Programe për personat me varësi nga alkool*

2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

2.1 Situata e mbrojtjes shoqërore në Bashkinë Prrenjas

Drejtuesit dhe stafi i sektorit të shërbimit social, administratorët shoqëror në njësitë administrative, përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Elbasan, si dhe organizatat që punojnë në territorin pranë dhe në Bashkinë Prrenjas identifikuan një numër sfidash dhe nevojash që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në mënyrë të veçantë:

- ✓ **Në territorin e Bashkisë Prrenjas janë ofruar dy shërbime të cilat lidhen me aftësinë e kufizuar dhe të moshuarit. Ndërkohë analiza e vlerësimit të nevojave identifikoi një numër të konsiderueshëm individësh në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, nevoja që mbeten të adresuara dhe të paadresuara pikërisht nga mungesa e këtyre shërbimeve.**
- ✓ **Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki, Sektori i shërbimit social, është i organizuar me një model miks mes një njësie përgjegjëse për të planifikuar shërbime të kujdesit shoqëror dhe njësisë që ka dhe role e përgjegjësi për nivelin e njësisë administrative Prrenjas. Mungon roli dhe funksioni drejtues, koordinues, monitorues, prokurues për të gjithë sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë bashki.**
Kjo mungese manifestohet në faktin që stafi është i familjarizuar me procese teknike të punës si menaxhim rasti, shërbimet e kujdesit shoqëror dhe roli i tyre, por është disi ose aspak i familjarizuar me konceptet e politikave sociale kombëtare, planifikimin e shërbimeve sociale, shportën e shërbimeve, kostimin e shërbimeve, modelin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në familje.
- ✓ Mungojnë kapacitetet në Bashkinë Prrenjas për planifikimin e shërbimeve sociale, sikurse vlerësohet e moderuar aftësia për të përdorur informacionin statistikor për të hartuar raporte të vlerësimit të nevojave dhe plane komunitare për shërbime. Në bashki nuk ka në strukturën përkatëse Nëpunës të Barazisë Gjinore.
- ✓ **Në njësitë administrative nuk janë ngritur Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit,** mungojnë stafet me punonjës social dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijës, mungesë që pengon ushtrimin e funksioneve dhe të përgjegjësive të Bashkisë në këtë nivel të organizimit vendor që është shumë më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Qytetarëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror u duhet të udhëtojnë drejt Bashkisë Prrenjas, pasi në njësitë administrative kanë vetëm mundësinë e aplikimit për ndihmë ekonomike, si dhe kryejnë procedurë për pagesat e aftësisë së kufizuar. Mungesa e strukturave lokale për identifikimin e rasteve sociale në njësitë administrative

reflektohet edhe në numrin e vogël të individëve të identifikuar në nevojë për shërbime, ndërkohë që gjatë procesit të validimit të treguesve për individët në nevojë, të gjithë aktorët publikë e jopublikë pranonin që ka shumë më tepër individë në nevojë për secilin prej grupeve të identifikuara.

- ✓ **Evidentohet gjithashtu vështirësia e stafit të sektorit të shërbimit social për të patur akses tek të dhënat statistikore të disagreguara gjinore të cilat duhet të percillen nga institucione të tjera.** Ky fakt do të ndihmonte në identifikimin e grupeve vulnerabël, nevojat për shërbime, planifikimin e ndërhyrjeve për të përmirësuar situatën e vulnerabilitetit të individëve dhe grupeve në nevojë. Kjo vështirësi e evidentuar pengon edhe raportimin sipas ligjit veçanërisht të PMF dhe koordinatorit për dhunën në familje dhe barazinë gjinore tek institucionet në nivel kombëtar.
- ✓ **Mungesa e buxhetit për shërbime të kujdesit shoqëror,** madje edhe për menaxhimin e rasteve emergjente, është pengesë kryesore në ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve. Mungesat financiare manifestohen edhe në infrastrukturën e papërshtatur për punën me fëmijët të PMF, sikurse dhe në mungesa materiale të zyrave të administratorëve shoqëror.
- ✓ Ndërkohë **numri shumë i limituar i organizatave që kanë aktivitet që targeton grupet vulnerabël në territorin e bashkisë Prrenjas,** si dhe **mungesa e ofruesve jopublik të shërbimeve të kujdesit shoqëror** e bën edhe më sfidues realitetin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki.
- ✓ **Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional** vihet re jo vetëm në mosfunksionimin e mekanizmave ndërinstitucionalë që duhet të ngrihen e funksionojnë sipas ligjit, por edhe në menaxhimin e rasteve të ndryshme sociale, që në shumicën e rasteve barra mbetet vetëm tek strukturat e Bashkisë.
- ✓ Për t'ju përgjigjur realisht nevojave të individëve për mbrojtje dhe shërbime, por edhe për të vepruar në përputhje me standartet e përcaktuara nga legjislacioni dhe strategjitë specifike kombëtare, është e domosdoshme që të kalohet nga qasja ku pagesa cash shihej si e vetmja formë e mbështetjes së familjeve dhe individëve në nevojë, tek qasja që vendos në qendër nevojat komplekse të individit dhe familjes, mbështetjes me shërbimet sipas nevojave të identifikuara përmes modelit të menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektori

2.2 Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuarat për individët dhe grupet në nevojë në territorin e Bashkisë Prrenjas, si dhe mbi shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror prezantohen në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

Tabela 1: Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror sipas individëve/grupeve në nevojë

Nr.	Individë/grupe në nevojë për shërbime	Madhësia e grupit	Shërbimi i nevojshëm për të adresuar nevojat sipas shportës së shërbimeve	Egzistenca e shërbimit
-----	---------------------------------------	-------------------	---	------------------------

1	Persona me aftësi të kufizuara	Individë:860 ¹ a. 588 persona me probleme të shëndetit fizik e mendor/ 419 në zonë rurale b. 58 persona para dhe tetraplegjik/ 39 në zonë rurale c. 151 persona të verbër/ 116 në zonë rurale	a. shërbim shëndetësor terapi zhvillimi terapi okupacionale b.shërbim shëndetësor fizioterapi shërbim në shtëpi c.shërbim shëndetësor shërbime rehabilitimi	<i>Vetëm shërbim shëndetësor dhe pagesa cash</i> <i>Terapi zhvillimi, fizioterapi dhe shërbim në banesa është ofruar vetem për fëmijët</i>
2	Përfitues të Ndhmës ekonomike	2.341 familje/ 2003 në zonë rurale	shërbim në shtëpi (paketa ushqimore) programme riintegrimi ne tregun e punës	<i>Vetëm pagesa cash</i>
3	Punëkërkuar të papunë	6.614 individë/ 5.336 në zonë rurale	këshillim për punësim program punësimi	<i>Jo,nuk ekziston si shërbim</i>
4	Viktima të dhunës në familje²	30 individë	shërbimi emergjencës 72 orëshe shërbim shëndetësor konsulencë ligjore shërbim psikologjik program punësimi	<i>Mungesa e ambienteve dhe stafit për të ofruar shërbimin e emergjences 72 orësh për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijve në bashki</i>
5	Familje të pastreha	250 familje	bonus qeraja strehimi social rikonstruksion banese	<i>Po</i> <i>Jo</i> <i>Po</i>
6	Të moshuar në nevojë për shërbime	65 të moshuar	qendër ditore shërbim në shtëpi	<i>Po</i> <i>Po</i>
7	Familje që kanë përjetuar divorc	4 në Rrajce 4 në Stravaj	shërbim psikologjik	<i>Jo</i>
8	Fëmijë të akomoduar në shërbim rezidencial	2	shërbim i kujdesit në familje kujdestare	<i>Në nivel kombëtar</i>
9	Fëmijë me aftësi të Kufizuara në shërbim rezidencial	1	shërbim i kujdesit në familje kujdestare shërbim rehabilitues dhe zhvillues	<i>Në nivel kombëtar</i>
10	Fëmijë në nevojë për mbrojtje	30	shërbime në qendër ditore (ndjekje e shkollës, aktivitet riintegruar, fuqizim familje)	<i>jo</i>

¹ Nga këta 109 janë fëmijë me aftësi të kufizuara

² Shifra është indikative, pasi raportohet që në realitet ka shumë më tepër raste dhune por që nuk raportohen tek institucionet.

11	Fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike	3.864 fëmijë/3.135 në zonë rurale	shërbime në qendër ditore (ndjekje e shkollës, aktivitet riintegruës, fuqizim familje) vendosja e kuotave për përfshirjen në kopshte dhe çerdhe për grupmoshat respektive	Jo
12	Fëmijë në familje kujdestare	1(nje)	monitorim ngritje e shërbimit në familje kujdestare	Jo
13	Fëmijë me aftësi të të kufizuara	109 fëmijë/ 88 në zonë rurale	shërbime rehabilitimi dhe zhvillimi qendër ditore/shërbim në familje shkolla dhe kopësht të aksesueshme	Po Po
14	Fëmijë të arrestuar/ndaluar/dënuar	1(nje)	programe riintegrimi	Jo
15	Familje rome dhe egjiptiane	Familje egjiptiane 71 Familje rome 2 NJA-Rrajcë 30 familje egjiptiane NJA-Qukës 13 familje egjiptian NJA-Stravaj 7 familje egjiptian Prrenjas 23 familje egjiptiane dhe 2 familje rome	programe sipas nevojave të identifikuar Bonus qerae	Jo Po
16	Përdorues droge	Nuk ka të dhëna zyrtare	programe rehabilitimi dhe riintegrimi	Jo
17	Viktima trafikimi	Nuk ka	informim i komuniteteve për të parandaluar rastet	Jo
18	Familje/individë të kthyer nga emigracioni	Nuk ka të dhëna zyrtare	programe riintegrimi sipas nevojave të identifikuar	Jo

Në përputhje me nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë të identifikuar, si dhe me shportën bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror të përcaktuar në Ligjin "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", u identifikuan nevojat prioritare për shërbime të cilat përfshijnë veçanërisht:

- Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe familjen përmes një qendre multifunktionale krijon mundësinë për të ofruar një numër shërbimesh për disa prej grupeve të identifikuar në nevojë duke kombinuar shërbimin komunitar me shërbimin në familje, specifikisht:
 - ✓ Programe këshillimi për prindërimin
 - ✓ Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm

- ✓ Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje
 - ✓ Programi i trajnimit të familjes kujdestare (shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm)
 - ✓ Shërbime në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për terapi zhvillimi dhe distanca nga qendra multifunkionale i pengon në marrjen e shërbimit
 - ✓ Shërbim rehabilitues për fëmijët në konflikt me ligjin
 - ✓ Shërbim lëvizës në familje
 - ✓ Këshillim për punësimin
 - ✓ Programe për përdoruesit e drogave
 - ✓ Programe për personat me varësi nga alkooli
- Zhvillimi i shërbimit të kujdesit alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror, shërbimi në familje kujdestare, që adreson nga një anë nevojat e fëmijëve pa kujdes prindëror në nevojë për mbrojtje në situatë emergjente dhe nga ana tjetër parandalon shërbimin rezidencial për fëmijë.
 - Për personat me aftësi të kufizuara u konsiderua prioritare ngritja e një qendre ditore, ku përveç shërbimeve zhvilluese dhe rehabilituese të ketë edhe programe për mësimin e programit braille. Qendra duhet të mundësojë edhe transportin e personave nga zona më të largëta që kanë nevojë për shërbimin ditor. Shërbimi lëvizës u vlerësua i rëndësishëm në funksion të nevojave të personave me aftësi të kufizuara që për shkak të distancës nga shërbimi e kanë të pamundur të përfitojnë nga shërbimi komunitar. Mungesa e aksesit në ambiente dhe institucione publike e personave me aftësi të kufizuara duhet të adresohet se pari përmes kryerjes së një studimi për aksesueshmëri dhe më pas duke planifikuar dhe kryer ndërhyrje në infrastrukturën publike me qëllim heqjen e barrierave të lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara fizike.
 - Nevoja për të fuqizuar individët madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike duhet të adresohet përmes shërbimeve:
 - ✓ Programe integrimi në tregun e punës për pjestarët madhor të familjeve në ndihmë ekonomike, në sajë të ndërveprimit me Shërbimin kombëtar të Punësimin, përmes studimit të tregut të punës në Bashkinë Prrrenjas dhe vlerësimin real të nevojave për punë dhe më pas ofrimi i kurseve të formimit profesional sipas profilit të identifikuar nga studimi.
 - ✓ Rritje e numrit të çerdheve dhe vendosja e kuotave në kopshte dhe çerdhe për fëmijët e familjeve më në nevojë për të marrë shërbimin pa pagesë. Trajtimit me strehim social ose bonus qeraje të Ndërtimi i shërbimeve që fuqizojnë viktimat e dhunës në familje përfshin së pari riaktivizimin e shërbimit të emergjencës, mbështetjen juridike dhe psikologjike të viktimave të dhunës, sikurse dhe trajtimi me prioritet për strehim i viktimave të dhunës në familje dhe këshillim për familjet që kanë përjetuar dhunë në familje.
 - ✓ Vendosja e fokusit tek shërbimet për të moshuarit, për të cilët ka gjithashtu mungesa si të shërbimeve komunitare ashtu edhe në familje. Identifikohet nevoja për Qendër ditore për të moshuarit e kombinuar me shërbim në familje.
 - ✓ Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Vlerësimin të Nevojave dhe Referimit, të fokusuara në identifikimin e individëve në nevojë për shërbime, menaxhimin e rasteve sociale, mbështetjen për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e shërbimeve komunitare do të mundësojë referimin e tyre tek shërbimet respektive.
 - ✓ Ndërkohë rritja e bashkëpunimit me aktorë të tjerë lokalë që kanë detyrime ligjore në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, do të ndikojë si në rritjen e identifikimit të rasteve të individëve në nevojë për shërbime ashtu edhe në referimin e tyre tek shërbimet specifike.

2.3 Partneriteti me OJF-të

World Vision me financim nga BE dhe në bashkëpunim me Bashkinë Prrrenjas nëpërmjet projektit "Përgjigje gjithëpërfshirëse COVID-19 për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Shqipëri"

janë ofruar mbështetje 50 familje me sete ushqimore dhe paketa higjienike, mbështetje me mjete buqësore, artikuj të kujdesit shëndetësor, mjete shkollore, tableta dhe mbështetje cash.

Me mbështetjen e World Vision me financim nga BE dhe në bashkëpunim me Bashkinë Prrenjas për periudhën mars 2020 qershor 2022 nëpërmjet Projektit "Tungjatjeta Jetë...Prrenjas" është ofruar shërbimi lëvizës për 42 fëmijë më Aftësi të Kufizuar mbështetur më terapi zhvillimi, logopedi, fizioterapi dhe mbështetje sociale në 3 Njësitë Administrative Rrajcë, Qukës, Stravaj dhe pranë ambienteve të shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli" në Hapsirën Zhvëllimore marrin shërbimin e logopedisë dhe fizioterapisë 5 fëmije.

Një tjetër shoqatë që ka ofruar shërbim është dhe **Forumi i Gruas Elbasan** i cili ka në fokus dhunën ndaj gruas në familje, fuqizimin dhe integrimin e saj në shoqëri duke i ardhur në ndihmë me shërbime të ndryshme si strehim për 72, shërbim ligjor falas, mbështetje psikologjike, ndihmë me paketa ushqimore dhe bonus qeraje.

Në bashkëpunim me organizatën "**Në familje për familjen**" është bërë i mundur riaktivizimi i Këshillit të Sigurisë Publike i cili ka në fokus punën ndaj komunitetit dhe aksesshmerinë në shërbime të ndryshme si koshat e mbetjeve, ndriçimi etj. Ndërkohë World Vision, **MEDPAK** dhe **Kryqi i Kuq** kanë zbatuar programe specifike në territorin e bashkisë Prrenjas për:

- ✓ Mbrojtjen dhe fuqizimin e fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve në familjet më të varfëra;
- ✓ Fuqizimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të njohur legjislacionin;
- ✓ Programe fuqizimi për të rinjtë dhe veçanërisht fuqizimi për sipërmarrjen;
- ✓ Programe edukuese për shëndetin e të rinjve

3. TREGUESIT SOCIAL³

Mbledhja e treguesve social ishte një proces i rëndësishëm për përgatitjen e këtij plani, por që ndeshi me disa sfida:

- Për të dhënat demografike u përdorën burime të censusit 2011, sikurse dhe të dhënat më të fundit të gjëndjes civile. Kjo e fundit nuk i raporton të dhënat sipas grup moshës dhe gjinisë, madje nuk raporton të dhëna as për numrin e fëmijëve të ndarë sipas grupmoshës dhe njësive administrative. Të dhënat për fëmijët u mundësuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Bashkia dhe drejtoria Rajonale e SHSSH Elbasan kanë të dhëna të plota për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët, sipas kategorive të verbër, para dhe tetraplegjikë dhe PAK mendor e fizik për çdo njësi administrative. Të dhënat janë të detajuara edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas grupmoshave dhe njësive.
- Mungojnë tërësisht të dhënat për numrin e punëkërkuësve të papunë në Bashkinë Prrenjas pasi zyra rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit nuk disponon të dhëna të veçanta për punëkërkuësit e papunë në bashkinë Prrenjas. Për të krijuar një pamje qoftë edhe të përafërt (minimum) për situatën e papunësisë në këtë Bashki u identifikua nga skema e ndihmës ekonomike numri i pjestarëve madhorë në moshë pune nga këto familje. Ndërkohë nga INSTAT u morrën të dhëna për numrin e ndërmarrjeve ekonomike në bashkinë Prrenjas, por mungesa e të dhënave për numrin e të punësuarve në to pengonte kryerjen e një analize të thelluar mbi mundësinë/pamundësitë në tregun e punës në këtë Bashki.
- Të dhënat për ndihmën ekonomike dhe karakteristikat e familjeve përfituese janë të plota, të detajuara për çdo njësi administrative dhe mundësohen nga Rregjistri Elektronik Kombëtar i ndihmës ekonomike.
- Të dhënat për fëmijët në nevoja për shërbime në territorin e Bashkisë Prrenjas nuk janë të plota. Së pari të gjitha aktorët e konsultuar pranojnë që shifrat e mbledhura japin një numër më të vogël të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, krahasuar me situatën reale. Kjo lidhet kryesisht me mungesën e raportimit apo raportimit jo frekuent pranë PMF-së nga institucione të ndryshme që kanë detyra në

³ Në Aneks 2 gjeni të detajuar të gjithë treguesit social të mbledhur dhe analizuar për qëllimet e përgatitjes së Planit Social të Bashkisë Prrenjas

këndvështrimin e mbrojtjes së fëmijëve, sikurse dhe me mungesën e PMF në njësitë administrative e për rrjedhojë mungesën e një aktiviteti të vazhdueshëm për identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

- Të dhënat mbi arsimin nuk janë të plota, pasi mungojnë të dhënat për numrin e mësuesve dhe mbi raportin mësues/nxënës, sikurse dhe numri i fëmijëve që ndjekin kopshtet në njësitë administrative nuk është i plotë.
- Numri i rasteve të dhunës në familje është më i lartë se sa shifrat e raportuara, pasi janë raportuar rastet me urdhër mbrojtje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtje, ndërkohë që në shumë raste viktimat nuk i drejtohen institucioneve për mbështetje.

4. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL

4.1 Parimet

Në përgatitjen e Planit Social Vendor Bashkia Prrenjas u udhëhoq nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në legjislacionin kombëtar dhe specifikisht:

- ✓ Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
- ✓ Grupe të veçanta, përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
- ✓ Krijimi i një mjedis të përshtatshëm që të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve. Individët janë përgjegjës për jetën e tyre dhe çdo shërbim duhet të respektojë parimin e pavarësisë dhe autonomisë së tyre.
- ✓ Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
- ✓ Vendimarrja në nivel vendor udhëhiqet nga standartet kombëtare.

Përgjatë përgatitjes së Planit Social Vendor Bashkia Prrenjas synonte jo vetëm të identifikonte individët dhe grupet në nevojë për shërbime, si dhe shërbimet e nevojshme që duhen ngritur me qëllim adresimin e nevojave të tyre, por edhe zhvillimin e një Plani që është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023.

4.2 Vizioni

Bashkia Prrenjas synon të ndërtojë një sistem vendor të mbrojtjes sociale për individët, gra dhe burra dhe grupet në nevojë përmes ngritjes dhe funksionimit të një sistemi të integruar shërbimesh të kujdesit shoqëror që mban në qendër individin dhe nevojat e tij, duke zbatuar qasjen e mbështetjes së çdo individi në përputhje me nevojat dhe fuqizimit të tij/saj për të mundësuar integrimin në jetën ekonomike dhe sociale.

4.3 Objektivat

Pesë objektiva strategjikë pritet të përmbushen nga zbatimi i Planit Social Vendor të Bashkisë Prrenjas dhe specifikisht:

Objektivi strategjik 1: Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale

Ky objektivi përgjigjet realitetit të ri ligjor dhe konceptit të ri të ngritjes dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ku Bashkia merr role e përgjegjësi në dy nivelet e organizimit: në Bashki përmes strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në njësinë administrative përmes Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. **Objektivi do të përmbushet përmes:**

- ✓ *Ristrukturimit dhe plotësimit të strukturës përgjegjëse në Bashki në përputhje me legjislacionin, ku përveç rishikimit të detyrave funksionale parashikohet për herë të parë pozicioni i koordinatorit për fuqizimin ekonomik dhe nëpunësit të barazisë gjinore.*
- ✓ *Ngritjes në tre njësiti administrative Qukës, Rrajcë, Prrenjas të Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e për rrjedhojë plotësimit të tyre me punonjës social dhe punonjës së mbrojtjes së fëmijës, si dhe plotësimi i strukturës me staf punonjës social në njësinë administrative Stravaj.*
- ✓ *Ofrimit të trainimeve, sipas nevojave të identifikuar për trainim, për stafet e shërbimit social në të dy nivelet e organizimit.*

Objektivi strategjik 2: Fuqizimi i qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale

Bashkia nuk është i vetmi aktor që ka detyrimin për adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, kjo në përputhje me legjislacionin, sikundër edhe është qasja e duhur për të menaxhuar rastet shpesh komplekse sociale. Përmeshja e këtij objektivi mundësohet përmes një numri ndërhyrjesh si:

- ✓ *Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe Grupit Teknik Ndërsektorial.*
- ✓ *Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve mbi punën e NJMF dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e fëmijëve.*
- ✓ *Ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe Ekipit Teknik Ndërdisciplinor për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.*
- ✓ *Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave mbi detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.*
- ✓ *Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave të mbrojtjes së individëve dhe grupeve në nevojë, të dhëna që duhet të vijnë nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë strukturave të Bashkisë dhe janë një bazë e rëndësishme për planifikimin dhe rishikimin e planeve sociale lokale në vijim.*

Objektivi strategjik 3: Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Ndërhyrjet për përmeshjen e këtij objektivi janë parashikuar në **katër drejtime** që plotësojnë njëra-tjetrën:

1. *Parandalimi i rasteve të dhunës, abuzimit dhe neglizhimit, që do të mundësohen përmes fushatave të informimit mbi të drejtat e fëmijës dhe masat për mbrojtje, si dhe takimeve komunitare me qëllim informimin në lidhje me dhunën në familje dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale për ta parandaluar dhunën.*
2. *Rritja e identifikimit të rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror.* Synohet që përmes aktiviteteve të parashikuara stafet sociale dhe shërbimet të shkojnë atje ku janë individët në nevojë. Një nga arsyt pse numri i individëve në nevojë të identifikuar gjatë përgatitjes së këtij plani është më i ulët se sa realiteti i perceptuar nga aktorët lokal në kontakt me komunitetin është fakti që mungojnë aktualisht mekanizmat për ti identifikuar individët në nevojë në komunitet dhe jo vetëm kur ata i drejtohen institucioneve për mbështetje. Për ta mundësuar këtë në Plan parashikohet:
 - ✓ *Trainim i kryetarëve/kryetareve të fshatrave për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, pasi ata janë në kontakt me komunitetin.*
 - ✓ *Takime informuese të stafit të Nj. V.N.R me institucione lokale prej nga mund të referohen raste të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime.*
 - ✓ *Afishimi dhe publikimi i numrit të dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të individëve në nevojë.*
3. *Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror, parashikon ndërhyrje në nivelin e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, e cila në*

përputhje me legjislacionin në fuqi ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë në menaxhimin e rasteve sociale dhe referimin tek shërbime të kujdesit shoqëror sipas nevojave të individit.

4. *Ngritja dhe funksionimi i rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që do të mundësohet nga ngritja dhe funksionimi gradual gjatë periudhës tre vjecare të zbatimit të këtij Planit:*

- ✓ Qendër multifunkionale për fëmijën dhe familjen
- ✓ Qënder multifunkionale për të moshuarit, grate viktime të dhunës dhe fëmijët
- ✓ Shërbimet të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare
- ✓ Shërbimet të emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje.
- ✓ Vazhdimësia e qendrës ditore për të moshuarit dhe shërbim në familje. Vazhdimi i qendrës ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Parashikohet gjithashtu kryerja e një studimi mbi situatën e aksesueshmërisë në institucionet dhe ambientet publike për tu pasuar me plane investimi që garantojnë ambiente publike të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi strategjik 4: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë

Për përmbushjen e këtij objektivi do të punohet përmes qasjes së mbështetjes me ndihmë ekonomike, por si një masë tranzitore e shoqëruar me një numër shërbimesh që fuqizojnë individët madhorë të familjeve në nevojë dhe i riintegrojnë në tregun e punës në sajë të bashkëpunimit me Shërbimin kombëtar të punësimit. Aktivitetet kryesore të parashikuara në funksion të **përmbushjes së këtij objektivi** janë:

- ✓ *Identifikimi i familjeve ekstremisht të varfra, përfituese dhe jopërfituese të ndihmës ekonomike.*
- ✓ *Mbështetje emergjente për nevojat bazë të familjeve në nevojë.*
- ✓ *Referimi tek këshillimi për punësim.*
- ✓ *Ndërveprimi me Shërbimin Kombëtar të Punësimit për zhvillimin e programeve të nxitjes së punësimit, duke mundësuar së pari vlerësimin e tregut të punës në këtë Bashki, për të vijuar me kurse profesionale sipas kërkesave të tregut dhe targetuar veçanërisht pjestarët madhorë të familjeve në ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara. Viktimat e dhunës në familje, gratë kryefamiljare.*
- ✓ *Alokimi i kuotës prej 5% në çerdhe dhe kopshte për fëmijët në nevojë për mbrojtje.*
- ✓ *Trajtimi me bonus qeraje ose banesë sociale të familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike.*

Objektivi strategjik 5- Përfshirja e grupeve vulnerabël në proceset e vendimarrjes

Përfshirja e grupeve vulnerabël në proceset e vendimarrjes është së pari domosdoshmëri për vetë zbatimin e Planit Social dhe rishikimin e tij duke mbajtur në konsideratë mendimin dhe vlerësimin e përfituesve të tij, së dyti është një mjet për të garantuar llogaridhënien e vendimarrësve lokal në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror. **Përfshirja do të mundësohet përmes:**

1. *Rritjes së informimit institucional dhe komunitar mbi të drejtat e fëmijëve, grave dhe çdo individ në nevojë.* Plani parashikon:

- ✓ Afishimin në çdo institucion publik të detyrimeve të institucioneve.
- ✓ Një seksion i veçantë për shërbimet sociale në faqen e web të Bashkisë do të plotësohet e përditësohet me informacion me interes për publikun në drejtim të legjislacionit dhe rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

2. *Ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave që mundësojnë përfshirjen e fëmijëve, grave dhe grupeve në nevojë në proceset e vendimarrjes në Bashki.* Plani parashikon:

- ✓ Konsultim i buxhetit dhe planit të veprimit vjetor të Bashkisë me fëmijët, gratë dhe grupe në nevojë.

5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT

5.1 Zbatimi

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë katër vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar qartësisht koha e zbatimit. Në përcaktimin e kohës së zbatimit janë mbajtur në konsideratë dy faktorë:

1. **Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave.**
2. **Kostoja e çdo aktiviteti dhe shpejtësia e ngritjes së fondit social lokal.**

Duke qenë që janë ende në proces aktet nënligjore që rregullojnë mekanizmin e financimit, ndërhyrjet me kostot më të larta, kryesisht ngritja e shërbimeve komunitare, janë parashikuar të ndodhin në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt të planit, duke përdorur vitin e parë jo vetëm për ngritjen dhe përgatitjen e strukturave lokale, si dhe të kushteve për ngritjen e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe për të ngritur fondin social lokal të Bashkisë Prrrenjas me fonde kryesisht nga Bashkia, qeveria qendrore dhe donatorë.

Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësi/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, partneriteti me organizata ofruese shërbimesh apo që kanë projekte për të ofruar shërbime në periudhën e zbatimit të këtij plani është pasqyruar në këtë Plan. Gjithsesi zgjerimi i këtij partneriteti me organizata/ofrues të tjerë do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Prrrenjas.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

5.2 Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi sesa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme objektivat strategjike dhe specifike të planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësi/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të kalojë përmes:

- ✓ Mbledhja e të dhënave;
- ✓ Analizimi i të dhënave;
- ✓ Raportimi;

Mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar është një etapë thelbësore e procesit të monitorimit. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit të Veprimt (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare.

Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen tre vlerësime me rëndësi strategjike pasi do të influencojnë drejtpërdrejtë në riorganizimin dhe riformulimin e objektivave specifike dhe aktiviteteve për vitet

pasuese:

- 3 vlerësime dhe Raporte vjetore (fund i 2023, fund i 2024 , dhe 2025). Këto raporte do shërbejnë edhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës.
- Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i 2026). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.

Përgjatë fazës së përgatitjes së këtij Plani stafi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror u trajnuar edhe për komponentin e monitorimit dhe vlerësimit me qëllim që të ketë kapacitetin për ta zhvilluar këtë proces të rëndësishëm. Ndërkohë vetë përfituesit e aktiviteteve të zbatuar në kuadër të këtij plani do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi siç u shpjegua në objektivin strategjik 5 Bashkia do të ngrejë mekanizma për të marrë mendimin e tyre në vendimarrje të rëndësishme, siç është edhe zbatimi dhe rishikimi i këtij Plani.

Monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm

Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

PLANI SOCIAL BASHKIA PRRENJAS

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1 - FUQIZIMI I STRUKTURAVE DHE KAPACITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: Ristrukturimi dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse në përputhje me legjislacionin.							
<p>Aktiviteti 1: <i>Riorganizimi, miratimi i strukturës dhe përshkrimeve të punës së strukturës përgjegjëse të shërbimit social në Bashki⁴</i></p> <p><i>Rishikim i përshkrimit të punës për çdo pozicion dhe struktura : Drejtori</i> <i>Punonjës social -1</i> <i>punonjës social-koordinator i fuqizimit ekonomik-1</i> <i>Koordinatori vendor për dhunën në familje – 1</i> <i>Punonjës per barazine gjinore 1</i> <i>Punonjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve 2</i> <i>Nëpunës i Barazisë gjinore-1</i></p>	Sektori i shërbimit social Drejtoria juridike	Nëntor- Dhjetor 2022	Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë Prrenjas përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse dhe çdo specialisti sipas parashikimeve e ligjore;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji “Për ndihmën ekonomike”	Bashkia Prrenjas	10.461.600	Sekretari i Përgjithshëm

⁴ Shih rekomandimi 1 dhe 2 faqe 28, Raporti i Vlerësimit të Nevojave

<p>Aktiviteti 2: Përgatitja dhe miratimi i strukturës, si dhe përshkrimeve të punës së Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit⁵.</p> <p>Aktiviteti 2.1 Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë Administrative Prrenjas Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura: punonjës social - 1 (shitesë) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1(shitesë) administrator shoqëror - 2</p> <p>Aktiviteti 2.2: Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Qukës Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura: punonjës social - 1 (shitesë) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1(shitesë) administrator shoqëror - 2</p>	<p>Spektori i shërbimit social Drejtoria juridike</p>	<p>Nëntor-dhjetor 2022</p>	<p>Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;</p> <p>Rregullorja e Bashkisë Prrenjas përmban përshkrim të ri pune për strukturën e Nj.V.N.R në njësinë administrative dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>28.500</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
--	---	----------------------------	--	--	-------------------------	---------------	---------------------------------

⁵ Shih rekomandimet 3-5 faqe 30-31, Raporti i Vlerësimit të Nevojave

<p>Aktiviteti 2.3 :Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësinë administrative Rrajcë Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura: punonjës social - 1 (shitesë) punonjës i mbrojtjes së fëmijës - 1(shitesë) administrator shoqëror - 2</p> <p>Aktiviteti 2.4 : Rishikim i përshkrimit të punës dhe shitesë stafi njësia administrative Stravaj: administrator shoqëro r- 2 (shitesë 1)</p>							
--	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi specifik 2: *Ngritja e kapaciteteve të stafëve nënshtrimin e detyrave funksionale dhe menaxhimin e rasteve sociale.*

<p>Aktiviteti 1. <i>Trainim i stafit të strukturës përgjegjëse të shërbimit social në Bashki.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Trainimet do të zhvillohen gradualisht gjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të planit dhe duhet të kenë në fokus • <i>Planifikimi i shërbimeve të përgjigjshme gjinore të kujdesit shoqëror;</i> • Hartimi i sistemeve për të mbështetur menaxhimin, implementimin, komunikimin dhe përgjegjësinë; • Monitorimi dhe vlerësimi; • Konsultimet me aktorët kryesorë; • Puna me shërbimin jopublik, krijim rrjeti komunikimi dhe 	<p>Drejtoria e Shërbimit Social</p>	<p>2022 2023 2024 2025 Tetor 2022</p>	<p>Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuar për ngritje kapacitetesh;</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p> <p>Partneritet me SHSSH dhe organizata joqeveritare</p> <p>UN Women</p>	<p>514.500 (per aktivitetin 1)</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
---	-------------------------------------	--	---	--	--	-------------------------------------	---------------------------------

<p><i>bashkëpunimi për ofrim shërbimesh dhe referime rastesh urgjente.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Prokurimi ishërbimeve të kujdesit social;</i> • <i>Hartimi i projekteve</i> 			<p>Praktika pune të përmirësuar në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;</p>	<p>Ligji "për ndihmën ekonomike"</p> <p>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"</p> <p>Ligji "Për prokurimin Publik"</p>			
<p>Aktiviteti 2. Trainim i stafëve të Nj.V.N.R.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Njohuri mbi paketën legjislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.</i> • <i>Teknika të menaxhimit të rasteve sociale.</i> • <i>Trainime specifike të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, masat e mbrojtjes.</i> • <i>Trainim i punonjësve social në mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje.</i> 	<p>Drejtoria e Shërbimit Social</p>	<p>2022</p> <p>2023</p> <p>2024</p> <p>2025</p>	<p>Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuara për ngritje kapacitetesh;</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë;</p> <p>Praktika pune të përmirësuar në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet ekujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"</p> <p>Ligji "Për vetqeverisjen vendore"</p> <p>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p> <p>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"</p> <p>Ligji "për ndihmën ekonomike"</p> <p>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"</p>	<p>Bashkia Prrenjas në partneritet me SHSSH, ASHMDF, organizata joqeveritare me ekspertizë në fusha specifike</p>		<p>Sekretar i Përgjithshëm</p>

OBJEKT IVI STRATEGJIK 2 - FUQIZIMI I QASJES NDËRSEKTORIALE NË MENAXHIMIN E RASTEVE SOCIALE

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objekti specifik 1: Krijimi i kushteve për ndërveprim institucional							
<p>Aktiviteti 1. Krijimi i bazës së të dhënave të disagreguara me pikat e kontaktit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Institucioneve publike në nivel lokal (polici, prokurori, gjykatë, shëndetësi, arsim) Institucioneve publike në nivel rajonal dhe kombëtar (Ministritë e linjës, SHSSH, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e fëmijës etj) Ofrues shërbimesh publike dhe jopublike në nivel lokal, rajonal, kombëtar) 	Drejtoria e Shërbimit Social	Janar 2023	<p>Data base e ngritur dhe përmban të dhëna me pika kontakti për çdo institucion lokal, rajonal, kombëtar, organizata ofruese shërbimesh në nivel rajoni;</p> <p>Aksesi në bazën e të dhënave i stafit në nivelin e Bashkisë dhe NjVNR sipas fushës së përgjegjesisë;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p> <p>Ligji "për ndihmën ekonomike"</p> <p>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"</p>	Bashkia Prrenjas	28.500	Sekretari i Përgjithshëm

<p>Aktiviteti 2. <i>Numër i dedikuar për rastet e emergjencës për individët në nevojë</i></p> <p><i>Në nivelin e Bashkisë vendoset dhe publikohet numër telefoni profesional i dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të fëmijëve, viktimave të dhunës në familje dhe çdo rast emergjence në nevojë për mbrojtje dhe shërbim</i></p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p> <p>Drejtoria e financës</p>	<p>Janar 2023</p>	<p>Numri i dedikuar i publikuar në ambientet e Bashkisë, njësite administrative, institucioneve publike lokale, faqen e web të Bashkisë;</p> <p>Numri i telefonatave të marra nga individë në nevojë për mbrojtje dhe/ose shërbime;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>111,690</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
---	---	-------------------	---	--	-------------------------	----------------	---------------------------------

Objektiv specifik 2: Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve

<p>Aktiviteti 1. <i>Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Takime të paktën një herë në 4 muaj të grupit</i> <i>Raportime mbi funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe referimit, koordinimi ndërinstytucional</i> <i>Raportime mbi situatën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në territorin e Bashkisë Prrenjas</i> 	<p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës</p>	<p>Shkurt 2023 2024 2025 2026</p> <p>Qershor 2023 2024 2025 2026</p> <p>Tetor 2023 2024 2025 2026</p>	<p>Numri i takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim;</p> <p>Minutat e takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i raporteve të prezantuara në secilin takim;</p>	<p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>86.000 (akt1 dhe akt.2)</p>	<p>Drejtoria e Shërbimit Social</p>
--	--------------------------------------	---	---	--	-------------------------	--------------------------------	-------------------------------------

			Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;				
<p>Aktiviteti 2. Ngritja dhe funksionimi i Grupit Teknik Ndërsektorial</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës organizon punën për thirrjen e mbledhjes së Grupit Teknik Ndërsektorial në nivel bashkie;</i> • <i>Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në tre njësitë administrative organizojnë punën për thirrjen e mbledhjes së Grupit Teknik Ndërsektorial në nivel njësie administrative;</i> • <i>Grupi Teknik Ndërsektorial mbledhet për vlerësimin e plotë, hartimin dhe miratimin e planit individual për mbrojtjen e fëmijës, përcaktimin e ndërhyrjeve dhe veprimeve të nevojshme nga organe apo struktura të ndryshme, marrjen dhe heqjen e Masës Emergjente dhe Masës së Mbrojtjes, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të PIM.</i> 	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës	Që prej shkurtit 2022, sipas nevojave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje	<p>Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsëktoriale;</p> <p>Numri i takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim;</p> <p>Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;</p>	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	Bashkia Prrenjas		Drejtoria e Shërbimit Social

<p>Aktiviteti 3. <i>Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve mbi punën e NJMF dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e fëmijëve.</i></p> <p><i>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim me përfaqësuesin e institucionit lokal respektiv realizojnë sesion informues me stafet e: Policisë vendore Shëndetësisë, Arsimit, Drejtësisë</i></p>	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës	Shkurt-dhjetor 2023	<p>Numri i takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara;</p> <p>Ndërveprim i përmirësuar mes NJMF dhe institucioneve të tjera që kanë role dhe përgjegjësi sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.</p>	Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	Bashkia Prrenjas	80.000	Drejtoria e shërbimit social
---	-------------------------------	---------------------	---	---	------------------	--------	------------------------------

Objektiv specifik 3. *Forcimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje*

<p>Aktiviteti 1: Ngritja dhe funksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Takime të paktën një herë në 4 muaj të Komitetit • Raportime mbi funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe referimit, koordinimi ndërinstytucional • Raportime mbi situatën e 	Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje	<p>Janar 2023 2024 2025 2026</p> <p>Maj 2023 2024 2025 2026</p> <p>Shtator 2023 2024 2025 2026</p>	<p>Numri i takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim;</p> <p>Minutat e takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i</p>	Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”	Bashkia Prrenjas	86,000 (akt.1 dhe akt.2)	Drejtoria e shërbimit social
--	--	--	--	--	------------------	--------------------------	------------------------------

<p><i>dhunës në familje në territorin e Bashkisë Prrenjas</i></p>			<p>raporteve të prezantuara në secilin takim; Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;</p>				
<p>Aktiviteti 2: Ngritja dhe funksionimi i Ekipit Teknik Ndërdisciplinor</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Koordinatori vendor organizon punën për thirrjen e mbledhjes së Ekipit Teknik Ndërdisciplinor;</i> <i>Grupi Teknik Ndërsektorial mbledhet për vlerësimin e plotë, hartimin dhe miratimin e planit individual për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje, përcaktimin e ndërhyrjeve dhe veprimeve të nevojshme nga organe apo struktura të ndryshme, mbështetjen me shërbime etj.</i> 	<p>Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje Punonjësit socialë të Nj.V.N.R të njësive administrative</p>	<p>Që prej janarit 2023 sipas nevojave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje</p>	<p>Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve që viktimat është mbështetur me shërbime fuqizuar; Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve institucionale pjesëmarrës në takim; Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;</p>	<p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>		<p>Drejtoria e shërbimit social</p>

<p>Aktiviteti 3. Takime informuese me institucionet vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave mbi detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen eviktimave të dhunës në familje</p> <p><i>Koordinatori vendor dhe NBGj në bashkëpunim me përfaqësuesin e institucionit lokal respektiv realizojnë sesion informues me stafet e: Policisë vendore, Shëndetësisë, Arsimit, Drejtësisë, Prokurorisë</i></p>	<p>Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje</p>	<p>Janar - dhjetor 2023</p>	<p>Numri i takimeve të zhvilluara;</p> <p>Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara; Ndërveprim i përmirësuar mes Bashkisë dhe institucioneve të tjera që kanë role dhe përgjegjësi sipas ligjit për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.</p>	<p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>80.000</p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p>
--	---	-----------------------------	--	---	-------------------------	---------------	-------------------------------------

Objektivi specifik 4 - Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave të mbrojtjes së individëve dhe grupeve në nevojë

<p>Aktiviteti 1. Përcaktimi i të dhënave që duhet të mblidhen, frekuencës së mbledhjes së tyre dhe burimit nga do të aksesohen të dhënat.</p> <p><i>Struktura përgjegjëse:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon treguesit që duhet të mblidhen • Burimin nga duhet të merren të dhënat • Frekuencën e mbledhjes së të dhënave • Idrejtohet zyrtarisht me kërkesë për bashkëpunim për qëllime të mbledhjes së të dhënave të gjitha institucioneve të identifikuar 	<p>Drejtoria e shërbimit social</p>	<p>Janar-shkurt 2023</p>	<p>Lista e treguesve që do të mblidhen;</p> <p>Frekuenca e mbledhjes së çdo treguesi;</p> <p>Burimi nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave; Shkresat zyrtare drejtuar institucioneve që zotërojnë të dhënat e nevojshme;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p> <p>Ligji "Për ndihmën ekonomike"</p> <p>Ligji "Për strehimin social"</p> <p>Ligj "Për arsimin parauniversitar"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>71.000</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
<p>Aktiviteti 2. Mbledhja e të dhënave sasiore dhe procesimi i tyre dhe i informacionit për situatën e të gjitha grupeve në nevojë për mbrojtje e përkujdesje.</p>	<p>Stafi i drejtorisë së shërbimit social Stafi i NjVNR</p>	<p>Sipas frekuencës së përcaktuar për çdo tregues në aktivitetin 1 (objektivi specifik 4)</p>	<p>Numri i të dhënave të mblidhura krahasuar me pritshmërinë;</p> <p>Numri i institucioneve që ndërveprojnë me Bashkinë Prrenjas.</p>	<p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore”</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p> <p>Ligji "Për ndihmën ekonomike"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>545.600</p>	<p>Drejtori i shërbimit social</p>

<p>Aktiviteti 3. <i>Analiza periodike multisektoriale e situatës së mbrojtjes së individëve dhe grupeve në nevojë</i></p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p>	<p>Çdo vit si pjesë e raportit Vjetor dhe rishikimit të Planit Lokal</p>	<p>Raporti Vjetor i aktivitetit për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkinë Prrenjas;</p> <p>Plani Social i rishikuar duke patur reference edhe analizën e grupeve në nevojë;</p>	<p>Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>180.800</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
--	-------------------------------------	--	---	--	-------------------------	----------------	---------------------------------

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3 - NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: <i>Parandalimi i rasteve të dhunës, abuzimit dhe neglizhimit.</i>							
<p>Aktiviteti 1: <i>Fushata informimi mbi të drejtat e fëmijës dhe masat për mbrojtje</i> <i>Çdo vit NJMF përgatit kalendarin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere në shkolla dhe komunitetet lokale, duke</i></p> <p><i>koordinuar me fushatat kombëtare</i></p> <p><i>u fokusuar në çështje të mbrojtjes së fëmijës që identifikohen si prioritare nga situata e të drejtave të fëmijës në territorin e Bashkisë.</i></p> <p><i>ndërvepruar me institucione të tjera lokale që kanë përgjegjësi specifike për çështjet e mbrojtjes së fëmijës.</i></p>	<p>Njësia e Mbrojtjes së fëmijës në Bashki Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në njësitë administrative</p>	<p>Qershor dhe tetor 2023 Qershor dhe tetor 2024 Qershor dhe tetor 2025 Qershor dhe tetor 2026</p>	<p>Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere të zhvilluara;</p> <p>Numri i fëmijëve të përfshirë në aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere;</p> <p>Numri i prindërve të përfshirë në aktivitete e fushatave;</p> <p>Përmbytja e materialeve dhe mesazheve të komunikimit përbushin qëllimet e fushatave;</p> <p>Numri i institucioneve lokale të përfshira në fushatat informuese dhe ndërgjegjësuere;</p>	<p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p>	<p>Bashkia Prrenjas ASHMDF World Vision</p> <p>partneritet me organizatat joqeveritare</p>	<p>402.000</p>	<p>Drejtori i Shërbimit Social</p>

<p>Aktiviteti 2: <i>Takime komunitare me qëllim informimin në lidhje me dhunën në familje, barazinë gjinore dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale për ta parandaluar dhunën. Çdo vit koordinatori vendor dhe NBGj në bashkëpunim me institucione të tjera lokale që kanë role e përgjegjësi për parandalimin e dhunës në familje :</i> <i>hartin programin e takimeve komunitare që mbulojnë të gjithë territorin. Harmonizon këtë program me fushatat kombëtare.</i></p>	<p>Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje dhe NBGj Punonjësit social të NjVNR Kryepleqtë</p>	<p>Nëntor 2023 Nëntor 2024 Nëntor 2025 Nëntor 2025</p>	<p>Numri i takimeve informuese dhe ndërgjegjësuere të zhvilluara;</p> <p>Numri i grave dhe burrave pjesëmarrës në takimet e zhvilluara;</p> <p>Përmbajtja e materialeve dhe mesazheve të komunikimit përmbushin qëllimet e fushatave;</p> <p>Numri i institucioneve lokale të përfshira në fushatat informuese dhe ndërgjegjësuere;</p>	<p>Ligji "Përmasat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p> <p>Forumi i Pavarur i Gruas Elbasan</p>	<p>402.000</p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p> <p>Administratorët e njësive administrative</p>
---	--	--	---	---	---	----------------	---

Objektivi specifik 2: Rritja e identifikimit të rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror.

<p>Aktiviteti 1: Përgatitja e paketës me formularët e dokumentimit dhe raportimit të rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Paketa e unifikuar u dërgohet për zbatim Nj.V.N.R</p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p>	<p>Janar-shkurt 2023</p>	<p>Numri i formularëve të përgatitur sipas parashikimeve ligjore për çdo grup në nevojë për shërbime; Paketa e dërguar zyrtarisht pranë NjVNR.</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për ndihmën ekonomike"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>	<p>48.000</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
<p>Aktiviteti 2. Trainim i kryepleqve për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime</p>	<p>Drejtoria e shërbimit social</p>	<p>Mars 2023 2024 (sipas nevojave në vijim) 2025 (sipas nevojave në vijim) 2026 (sipas nevojave në vijim)</p>	<p>Numri i kryepleqve pjesëmarrës në trainim; Numri i kryepleqve të përfshirë në procesin e identifikimit të individëve në nevojë për shërbime në territorin ku punojnë.</p>	<p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore”</p>	<p>Bashkia Prrenjas Partneritet me SHSSH dhe/ose organizatë joqeveritare</p>	<p>53.600</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm Administratorët e njësive administrative</p>

<p>Aktiviteti 3. Takime informuese të stafit të Nj.V.N.R me:</p> <p><i>drejtues shkollash, sistemi shëndetësor, gjyqtarë, polici, ofrues të shërbimeve lokale media</i></p> <p><i>Takimet do të synojnë t'i informojnë mbi shërbimet e NjVNR dhe shërbimet sociale në tërësi me qëllim referimin e rasteve të mundshme të individëve në nevojë për mbështetje.</i></p>	<p>Punonjësi social dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në NjVNR</p>	<p>Mars 2023 2024 (sipas nevojave) 2025 (sipas nevojave) 2026 (sipas nevojave në vijim)</p>	<p>Numri i takimeve informuese të zhvilluara;</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në takimet e zhvilluara; Përmbajtja e materialeve dhe mesazheve të komunikimit përmëshin qëllimet e takimeve;</p> <p>Numri i rasteve që referohen nga institucione të ndryshme në vijim të takimeve në sajë të rritjes së të kuptuarit të funksionimit të mekanizmit të referimit tek shërbimet sociale;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>		<p>Drejtoria e shërbimit social</p> <p>Administratori i njësisë administrative</p>
<p>Aktiviteti 4: Afishimi dhe publikimi i numrit të dedikuar për informim, koordinim, referim të rasteve të individëve në nevojë</p> <p><i>Publikimi në çdo njësi administrative dhe çdo institucion publik</i></p>	<p>NjVNR në çdo njësi administrative</p>	<p>Dhjetor 2022</p>	<p>Numri i ambienteve/hapësi si rave ku është publikuar numri i dedikuar; Numri i rasteve të emergjencës/informim të marra përmes numrit të dedikuar;</p>	<p>Ligji "për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>		<p>Drejtoria e shërbimit social</p> <p>Administratori i njësisë administrative</p>

Objektivi specifik 3: Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime të kujdesit shoqëror.

<p>Aktiviteti 1. Përmirësimi i infrastrukturës së punës së strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ambientet e punës së pajisura sipas nevojave të punës së stafit. • ambienti përshtatur për nevojat e punës me fëmijët (mjedis miqësor për fëmijët). • adresari me të gjitha kontaktet e sistemit të referimit dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. • paketa me të gjithë formularët e dokumentimit për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe çdo tip formulari të përcaktuar në legjislacion dhe akte nënligjore. • të tjera sipas detyrave të përcaktuara në ligj dhe akte nënligjore. 	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p> <p>Drejtoria e shërbimit social</p>	<p>2023</p>	<p>Ambientet e punës janë të përshtatshme për përmbushjen e detyrave funksionale dhe detyrimeve ligjore;</p> <p>Mjedisi miqësor për fëmijët; Mjedisi i sigurt për viktimat e dhunës në familje;</p> <p>Mjedisi miqësor për çdo individ në nevojë; Stafi administron dokumentacionin në përputhje me parashikimet ligjore;</p>	<p>Ligji "për vetqeverisjen vendore"</p> <p>Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p>		<p>1,291,600</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>
<p>Aktiviteti 2. Punonjësit e Nj. V.N.R menaxhojnë rastet sociale në nevojë për mbrojtje duke kryer:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin Fillestar; Vlerësimin e Plotë; Planifikimin e Mbrojtjes dhe Përkujdesit; 	<p>Punonjësit socialë</p> <p>Punonjësit e Mbrojtjes së fëmijës</p> <p>Administrator ë shoqërorë</p>	<p>Çdo ditë pune 2022-2026</p>	<p>Numri i rasteve të referuara;</p> <p>Numri i rasteve të menaxhuara;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"</p>	<p>Bashkia Prrenjas</p>		<p>Drejtoria e shërbimit social Administratorët e njësive administrative</p>

- *Informimin dhe këshillimin mbi të drejtat dhe shërbimet*
- *Përgatitjen e dokumentacionit për marrjen e shërbimit komunitar/familje/rezidencial sipas kriterëve ligjore*
- *Zbatimi, Monitorimi dhe Ndjekjen e Planit; Mbylljen e Rastit.*
- *Sigurojnë pjesëmarrjen e individit dhe familjes përgjatë çdo hapi të procesit të menaxhimit të rastit që nga identifikimi dhe deri tek mbyllja e rastit.*

Numri i individëve të referuar tek shërbimet sipas nevojës;

Numri i individëve që janë informuar e këshilluar nga stafi i NJVNR.

Numri i individëve të asistuar nga stafi për përgatitjen e dokumentacionit me qëllim përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;

Numri i individëve të fuqizuar në saj të përpjekjeve të koordinuara të drejtuara nga NJVNR.

Ligji "Për vetqeverisjen vendore"

Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"

Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"

Ligji "Për ndihmën ekonomike"

Objektivi specifik 4: Ngritja dhe funksionimi i rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

